

Diploma Profesionale në “**Agroturizëm dhe Mikpritje**”
(120 ECTC, 2 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional (PËRSHKRIMI I DEGËS)

Ky program studimi është projektuar duke menduar të rinjtë që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe dëshirojnë të përfitojnë një profesion në fushën e turizmit. Programi i studimit “Agroturizëm dhe Mikpritje” synon të ofrojë elementet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e aftësive në fushën e Agroturizmit dhe shërbimeve shoqëruese të tij. Studimet në këtë program sigurojnë njohuritë bazë dhe aftësitë profesionale në këtë fushë nëpërmjet integritit të mësimit me praktikën. Ky program formimi profesional, synon të sigurojë një nivel njohurish dhe aftësish praktike të domosdoshme për të realizuar me sukses aktivitetet që kryhen në një fermë agroturistike dhe në forma të tjera të turizmit alternativ.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

a. Formim i përgjithshëm

1. Legjislacioni në biznesin e turizmit
2. Komuniteti Rural dhe Turizmi
3. Komunikim Biznesi

b. Formim bazë karakterizues

1. Turizmi rural
2. Menaxhim i Akomodimit në Turizëm
3. Agroturizmi
4. Produktet e Territorit
5. Marketingu i Turizmit
6. Sistemet e kompjuterizuara të rezervimit në turizëm
7. Shtigjet dhe guidat turistike
8. Menaxhimi i Cilësisë në Turizmin Rural

c. Formim integrues.

1. Produktet blegtorale në agroturizëm
2. Teknologjitë e prodhimit të produkteve artizanale
3. Kopshtari dhe peisazh

Mundësitë për punësim

Sektorët kryesorë të punësimit të diplomuarve në shkollën e lartë profesionale „Agroturizëm dhe Mikpritje“ përfshijnë:

- Sektori privat, ku përfshin pozicione të ndryshme shërbimi në biznese të turizmit rural, agroturizmit bujtina, restorante, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afat-shkurtë, hoteleri, resorte dhe komplekse turistike. Gjithashtu të diplomuarit e këtij programi mund të punësohen në agjensi turistike dhe sipërmarrjet përpunuese të agrobiznesit. Gjithashtu të diplomuarit në “Agroturizëm dhe Mikpritje” mund të punësohen në turizmin masiv dhe në çdo biznes tjetër në shërbim me klientin;
- OJF shqiptare dhe të huaja që zbatojnë projekte në fushën e turizmit dhe zhvillimit rural

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Semestri	Nr	Modulet	Kredite
Viti I, Semestri I (1)	1	Legjislacioni në biznesin e turizmit	6
	2	Komuniteti Rural dhe Turizmi	6
	3	Anglishtja e Turizmit	3
	4	Komunikim Biznesi	6
	5	Turizmi rural	6
Viti I, Semestri II (2)	1	Anglishtja e Turizmit	3
	2	Menaxhim i Akomodimit në Turizëm	6
	3	Drejtimi i fermave	6
	4	Menaxhim Turizmi	6
	5	Agroturizëm	6
	6	Produktet e Territorit	6
Viti II, Semestri I (3)	1	Marketingu i Turizmit	6
	2	Sjellja e Konsumatorit Turistik	6
	3	Sistemet e kompjuterizuara të rezervimit në turizëm	6
	4	Shtigjet dhe guidat turistike	6
	5	Menaxhimi i Cilësisë në Turizmin Rural	6
Viti II, Semestri II (4)	1	Produktet blegtorale në agroturizëm	5
	2	Teknologjitë e prodhimit të produkteve artizanale	5
	3	Kopshtari dhe peisazh	5
	4	Praktikë Profesionale	11
	5	Provim Final	4
Totali i Krediteve		1+2+3+4	120